



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Nr. i referencës: 626-23-005-2-2-1

Me 15.06.2023
Mamushë

Në bazë të nenit 62 dhe nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (h) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet njoftimi B58 i datës 18.04.2023 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-23-1710-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-005-2-2-1 me titull: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”

II

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-23-1710-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-005-2-2-1

III

I njëjti do të rishpallet sipas procedurave të prokurimit, pas afatit për ankesa.

IV

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 09.03.2023 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026” me nr. të prokurimit: 626-23-1710-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-005-2-2-1. Pas njoftimit për kontratë dosjen e tenderit e kanë shkarkuar tridhjetë (30) Operatorë Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar gjashtë (6) prej tyre.

Pas vlerësimit të tenderit në fjalë Me datën **18.04.2023** kemi publikuar njoftimin B58 për dhënie të kontratës grupit të O.E. “Geo-Group” SH.P.K. & “Enggroup” SH.P.K.

Të pa kënaqur me vendimin e AK-s Grup i Operatorëve Ekonomik Arhiko .ING O.P.; Lekaj.ING SH.P.K. me datën **19.04.2023** kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-s. Pas shqyrtimit të kërkesës me vendimin **02 nr. 078-23** i është refuzuar kërkesa si pa bazuar.

Të pa kënaqur me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim Grup i Operatorëve Ekonomik Arhiko .ING O.P.; Lekaj.ING SH.P.K. me datën **02.05.2023** kanë paraqitur ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Pas shqyrtimit të ankesës, Paneli Shqyrtues i OSHP-s me vendimin **OSHP: 2023/0246** të datës **12.06.2023** ka vendosur që të anulohet procedurën e prokurimit në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (h) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

